 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Politika në lidhje me grupin e vlerësimit	Kodi DA-PO-003
		Rishikim nr 4 Dt: 20.05.2019
		Faqe 1 nga 2

Politika në lidhje me grupin e vlerësimit

1. Qëllimi

Ky dokument përshkruan politikën e Drejtorisë së Përgjithëshme të Akreditimit në lidhje me emërimin e grupit të vlerësimit, informimin e organizmit të vlerësimit të konformitetit në lidhje me përbërjen e grupit dhe mundësinë për mosaprovim. Ky dokument gjithashtu përshkruan edhe kodin e sjelljes.

2. Referimet

Kjo politikë bazohet në Standardin ISO / IEC 17011:2017 “Vlerësimi i Konformitetit - “Kërkesat për organizmat e akreditimit të cilat akreditojnë akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit”

3. Emërimi i grupit të vlerësimit

3.1 Grupi i vlerësimit emërohet nga DPA duke u bazuar në fushën e akreditimit, kriteret e akreditimit dhe kompetencën e vlerësuesve.


3.2 Secili anëtar i grupit vlerësues duhet të ketë kompetencën e duhur për një fushë specifike të akreditimit. Kur një grup vlerësimi po kryen vlerësimin, kompetencat e kërkuara duhet të mbahen brenda grupit vlerësues në tërësi.

3.3 DPA siguron grupi vlerësimit vepron në mënyrë të paanëshme dhe jo diskrimuese. Grupi i vlerësimit informon DPA, përpara vlerësimit në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti interesi të mëparshëm ose të parashikuar ndërmjet tyre, organizatës së tyre dhe OVK që do të vlerësohet. Grupi i vlerësimit deklaron paraprakisht që ata nuk kanë ndonjë konflikt interesi me OVK që do të vlerësohet dhe ata nënshkruajnë deklaratat e konfidencialitetit, paanëshmërisë dhe konfliktit të interesit DA-FO-010.

3.4 Madhësia e grupit të vlerësimit varet nga fushat për të cilat kërkohet akreditimi.

4. Informimi për grupin vlerësues

4.1 DPA informon organin e vlerësimit të konformitetit (OVK) mbi emrat e anëtarëve të grupit vlerësues dhe ndonjë vëzhguesi, dhe organizatës që ata i përkasin,

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Politika në lidhje me grupin e vlerësimit	Kodi DA-PO-003
		Rishikim nr 4 Dt: 20.05.2019
		Faqe 1 nga 2

detyra që u është dhënë atyre, mjaftueshmërisht më përpara për t'i dhënë OVK-së mundësinë për të kundërshtuar emërimin e ndonjë anëtari të veçantë të grupit ose vëzhguesi me justifikim mbështetës

4.2 Kur kundërshtimi është i arsyeshëm, DPA cakton një anëtar tjetër të grupit ose një grup tjetër vlerësimi. DPA i siguron OVK-së informacionin për emërimin e ri. DPA nuk ndryshon anëtarët e grupit kur kundërshtimi nuk është i arsyeshëm. Kur OVK refuzon ndonjë anëtar të grupit më shumë se dy herë rradhazi, DPA refuzon vazhdimin me aplikimin për akreditim

4.3 Kur DPA nuk gjen vlerësues nga database i brendshëm, ajo mund të angazhojë vlerësues të huaj që propozohen nga një organizëm kombëtar akreditues që është nënshkruese e EA MLA, ILAC MRA ose IAF MLA në fushën përkatëse. Përzgjedhja e propozimeve prej tyre bazohet në: disponueshmërinë, kostot, gjuhën e përdorur, etj. Përpara emërimit të një vlerësuesi të huaj, DPA i siguron atij procedurat, politikat dhe format e DPA, si dhe legjislacionin shqiptar përkatës, nëse ka. Vlerësuesi i huaj duhet të përmbushë të njëjtat kërkesa për pavarësi dhe paanshmëri si ato lokale.

4.4 DPA përdor kryevlerësuesit / vlerësuesit / ekspertët e jashtëm vetëm kur nuk ka të tillë brenda vendit, ose kur nuk sigurohet paanshmëria e atyre të vendit.

4.5 Pagesa e vlerësuesit të huaj do të bëhet sipas ligjit nr. 116/2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë".


5. Kodi i sjelljes

5.1 Anëtari i grupit vlerësues ose vëzhguesi duhet të jetë i vetëdijshëm se ai / ajo përfaqëson DPA dhe kryen vlerësimin në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara nga DPA.

5.2 Çdo sqarim në lidhje me politikat dhe procedurat e DPA duhet t'i adresohet drejtpërdrejtë DPA. Nëse kërkohet ndonjë sqarim gjatë vizitave vlerësuese, ai duhet të organizohet vetëm me përfaqësuesit e DPA dhe pa praninë e përfaqësuesve të organizmit të vlerësimit të konformitetit.

5.3 Anëtari i grupit vlerësues ose vëzhguesi duhet të komunikojë në mënyrë profesionale, miqësore dhe të kontrolluar me stafin e OVK si dhe me pjesën tjetër të grupit të vlerësimit.

5.4 Gjetjet dhe jokonformitetet duhet të paraqiten në mënyrë të qartë dhe të justifikuar.

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Politika në lidhje me grupin e vlerësimit	Kodi DA-PO-003
		Rishikim nr 4 Dt: 20.05.2019
		Faqe 1 nga 2

5.5 Çdo keqkuptim me personelin e OVK duhet të zgjidhet në mënyrë të qetë dhe të arsyetuar. Në rastet e keqkuptimit të vazhdueshëm, vlerësuesi duhet t'i shpjegojë OVK, procedurën e apelimit të DPA.

5.6 Anëtari i grupit vlerësues ose vëzhguesi nuk duhet t'i ofrojnë konsulencë OVK.

5.7 Anëtari i grupit vlerësues ose vëzhguesi duhet të ndjekë planin e vlerësimit dhe të respektojë kohën e planifikuar për vizitën vlerësuese dhe ta menaxhojnë atë sipas planit të vlerësimit. Nëse nevojitet zgjatja e kohës së vlerësimit, kjo mund të ndodhë vetëm pas marrjes së miratimit të stafit të OVK.

5.8 Anëtari i grupit vlerësues gjithashtu duhet të ketë parasysh se qëllimi i vizitës vlerësuese është vlerësimi i kompetencës teknike të OVK. Vizita vlerësuese nuk mund të përdoret për të demonstruar kompetencën e ekipit vlerësues.

5.9 Anëtari i grupit vlerësues duhet të jetë shumë i kujdesshëm.

5.10 Anëtari i grupit vlerësues nuk duhet të mbajë kontakte me OVK përkatëse, pa lejen me shkrim nga DPA, për çështjet e akreditimit, përveç atyre gjatë vizitave vlerësuese.


5.11 Anëtari i grupit vlerësues nuk duhet të pranojë dhurata, komisione, ulje ose përfitime të ndonjë natyre tjetër nga OVK e vlerësuar.

5.12 Anëtari i grupit vlerësues duhet të respektojë të gjitha afatet e përcaktuara nga DPA për dorëzimin e raporteve dhe formularëve. Ai / ajo duhet të mbajë konfidenciale të gjithë informacionin e marrë nëpërmjet dokumentacionit ose vlerësimit. Ai / ajo nuk duhet të bëjë kopje të dokumentave të siguruar nga DPA.

5.13 Anëtari i grupit vlerësues mund të japë informacion për OVK e vlerësuar vetëm me kërkesë me shkrim nga komisioni i ankesave ose apelimit ose sic kërkohet nga legjislacioni.

5.14 Informacioni i fituar gjatë vlerësimit nuk duhet të përdoret për qëllime personale të grupit të vlerësimit.

5.15 Ftesat për të folur në emër të DPA nuk duhet të pranohen pa miratimin paraprak të DPA.

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Politika në lidhje me grupin e vlerësimit	Kodi DA-PO-003
		Rishikim nr 4 Dt: 20.05.2019
		Faqe 1 nga 2

5.16 Vëzhguesit e DPA duhet të emërohen nga lista e personave të emëruar për të plotësuar orët e vlerësimit sipas rekomandimit në përputhje me procedurën DA-PM-002.

5.17 Vëzhguesit nuk kanë të drejtë të vlerësojnë ose të japin mendimin / sugjerimin e tyre gjatë vizitave vlerësuese.

5.18 Vëzhguesit duhet të mbajnë të fshehtë të gjithë informacionin e marrë dhe nuk duhet t'ia shpërndajnë atë ndonjë personi apo organizate tjetër (duke përfshirë edhe organizatën ose stafin e tyre) as tani as në të ardhmen pa autorizimin me shkrim nga DPA dhe OVK e vlerësuar. Ata nuk kanë të drejtë ta përdorin informacionin për qëllime personale.

5.19 Vëzhguesit nuk duhet të pranojnë ftesën për të folur në emër të DPA ose ta përfaqësojnë pa miratimin paraprak të DPA.

6. Pagesa e vlerësuesve / ekspertëve

Bazuar në Ligjin nr. 116/2014, pagesa e grupit të vlerësimit do të kryhet drejtpërdrejt nga DPA.

Drejtori i Përgjithshëm

Armond HALEBI